

VENDIM
Nr. 872, datë 30.9.2013

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 654, DATË 31.7.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQES NË NGASTRAT E EKONOMISË
“KRASTË-KRUJË”, KRUJË, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA “SHPRESA-AL”
SHPK, PËR SHFRYTËZIMIN E GURIT GËLQEROR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit dhe të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 654, datë 31.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes në ngastrat e ekonomisë “Krastë-Krujë”, Krujë, që do të përdoret nga shoqëria “Shpresa-Al” sh.p.k., për shfrytëzimin e gurit gëlqeror”.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama